

EPPC Albania në emër të klientit të saj, një ndër kompanitë më prestigjioze në sektorin e kujdesit shëndetësor në vend, aktualisht është duke kërkuar një **Inxhinier të Pajisjeve Mjekësore**.

Përgjegjësitë kryesore:

- Instalimi i pajisjeve mjekësore në objektet e kujdesit shëndetësor (spitale, klinika, laboratorë, etj.), sipas specifikimeve të prodhuesit dhe standardeve rregullatore;
- Kryerja e testeve të vazhdueshme të pajisjeve mjekësore për të siguruar sigurinë, funksionalitetin dhe pajtueshmërinë me standardet e industrisë;
- Sigurimi i mbështetjes për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve mjekësore në mjediset e kujdesit shëndetësor;
- Përgatitja e raporteve të detajuara të shërbimit, duke përfshirë përshkrimet e incidenteve, riparimet e bëra dhe rekomandimet për përmirësime;
- Bashkëpunimi me ekipe ndërfunksionale, duke përfshirë punonjësit e klinikave ose spitaleve dhe personelin prodhues;
- Ofrimi i trajnimeve dhe udhëzimeve për personelin mjekësor dhe përdoruesit.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare e preferueshme në **Inxhinieri Elektrike, Inxhinieri Elektronike, ose në fusha të tjera të ngjashme**;
- E preferueshme **1-2 vite eksperiencë pune në pozicione të ngjashme**;
- **Aftësi kompjuterike dhe për zgjidhjen e problemeve**;
- Aftësi të mira komunikimi.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj në linkun që vijon:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.